

Heritage
of Prishtina

Trashëgimia
e Prishtinës



Publisher:

CHwB - Cultural Heritage without
Borders, Kosovo

Project:

Remained Heritage of Prishtina

Founded by:

SIDA - Swedish International
Development Cooperation Agency

Project Management:

CHwB - Cultural Heritage
without Borders, Kosovo
Vlora Rizvanolli, *architect*

Project planning team:

Dr.-Ing Christine Kohlert
Gjejlane Hoxha, *architect*
Sali Shoshi, *architect*
Genc Gafurri, *cand. architect*
Edon Mullafetahu, *cand. architect*
Co-operators:
Zana Ramadani, *cand. architect*
Valmira Ajeti, *cand. architect*

External co-operators:

Dr.sc. Fejaz Drançolli, *art historian*
Eliza Hoxha, *architect*
and urban planner

Edited and Designed by:

Edon Mullafetahu *cand. architect*

Redactor:

Robert Wilton
Agron Gashi

Translation:

Rrita Qena Rodiqi

Printing:

PROGRAF

Circulation:

2,000

Publikuesi:

CHwB - Trashëgimia kulturore
pa kufij, Kosovë

Projekti:

Trashëgimia e mbetur e Prishtinës

Financuar nga:

SIDA - Agjensioni suedez për
zhvillim dhe kooperim ndërkombëtar

Menaxhimi i projektit:

CHwB - Trashëgimia kulturore
pa kufij, Kosovë
Vlora Rizvanolli, *arkitekte*

Grupi planifikues i projektit:

Dr.-Ing Christine Kohlert
Gjejlane Hoxha, *arkitekte*
Sali Shoshi, *arkitekt*
Genc Gafurri, *kand. arkitekt*
Edon Mullafetahu, *kand. arkitekt*
Bashkëpunëtorët:
Zana Ramadani, *kand. arkitekt*
Valmira Ajeti, *kand. arkitekt*

Bashkëpunëtor të jashtëm:

Prof. Dr. Fejaz Drançolli, *art historian*
Eliza Hoxha, *arkitekte*
dhe planere urbane

Editimi dhe Dizajnimi:

Edon Mullafetahu, *kand. arkitekt*

Redaktimi:

Robert Wilton
Agron Gashi

Përkthimi:


Rrita Qena Rodiqi

Shtypi:

PROGRAF

Tirazhi:

2,000



Heritage of Prishtina

Remained Heritage of Prishtina • Trashëgimia e Mbetur e Prishtinës



Heritage of Prishtina

Contents

4	Foreword
5	PRISH-TI-NA
6	Mosaic of Narrations
8	Erasing the past “Urban - ization”
12	Erasing the past “Rurban - ization”
13	Several notable Monuments in Prishtina
19	Urban Historic Zone in context of Urban Management
20	Urban History
20	Urban Management Tasks
24	Call for Action
27	Starting Point, Methods and Strategies
28	Need for Urban Planning and Managing
29	Remained Heritage of Prishtina
31	Analysis of Historic Monuments in Prishtina
61	Evolution of the old part of the city

Përmbajtja

4	Parathënie
5	PRISH-TI-NA
6	Mozaiku i rrëfimeve
8	Shlyerja e të kaluarës “Urban- izimi”
12	Shlyerja e të kaluarës “Rurban- izimi”
13	Disa objekte me vlera monumentale në Prishtinë
19	Zona historike urbane në kontekstin e menaxhimit urban
20	Historia urbane
20	Detyrat e menaxhimit urban
24	Thirrje për veprim
27	Pikë nisja, metodat dhe strategjitë
28	Nevoja për planifikim e menaxhim urban
29	Trashëgimia e mbetur e Prishtinës
31	Analiza e Monumenteve historike në Prishtinë
61	Evoluimi i pjesës së vjetër të qytetit

Foreword

Dear reader,

The Swedish foundation „Cultural Heritage Without Borders“ has enabled the publication of this document for one reason: to stir us to preserve something of the history of this city, which has been “determined” and experimented with so many times – as one of the writers here says, “the spirit of Prishtina has been assaulted”.

We have selected three authors to provide three initial and different points of view. It’s no surprise that these three have addressed the same issue: the saving of the memories of this city. I think everyone will agree that there’s no better choice for our discussion. This dwelling-place that has endured from the 13th Century, the 18th Century market and the capital city of Kosovo, Prishtina, is in danger of destroying its own history, whatever that may be.

The symbolic title of one of our pieces, PRISH-TI-NA, is a telling metaphor that reminds us of the challenges that have battered against this city.

The dominance of one period over others, of intolerance over cultural and social diversity, has led to the blind sweeping aside, the correction, and (in the case of Divan-njolli) the severance of the shapes and the components of the city. Today, in the new reality, explains Dr Kristina Kohlert, there is a pan-European prize for positive renovation that aims to promote innovative solutions to the problems of contemporary cohabitation. Of course, this is the fundamental question: “how can the new co-exist with what is left to us of the culture of this city?”

Perhaps the best way to answer this is a debate about the Union building. This monument could be a real union between Prishtina’s future and past. And perhaps, little by little, this new spirit of preservation could spread across the historic zone of Prishtina, which now only fully exists in the memories of her people.

Sali Shoshi

Director of the CHWB Mission in Kosovo

Parathënie

Të nderuar lexues,

Fondacioni suedez „Trashëgimia Kulturore pa Kufij“, ka mundësuar botimin e këtij publikimi për të vetmën arsye: që të mobilizohemi për të shpëtuar diçka nga kujtesa për këtë qytet, i cili u “shortua” dhe u eksperimentua disa herë, për të cilin njëri nga autorët në këtë publikim në mes të tjerave thotë: “Prishtinës i është sulmuar shpirti”.

Kemi përzgjedhur tre autorë për të parë tri këndvështrime të ndryshme. Nuk është aspak çudi se të gjithë kanë prekur të njëjtën çështje: SHPËTIMIN e kujtesës për këtë qytet. Dhe besoj, të gjithë pajtohen se nuk ka alternativë tjetër për të cilën mund të debatojmë. Prishtina si vendbanimi që përmendet nga shekulli XIII-të, qendër tregtare e shekullit XVIII-të dhe kryeqyteti i Kosovës, është në rrezik të zhbërjes së historisë së vet, çfarëdo qoftë ajo. Titulli simbolik PRISH-TI-NA i njërit prej shkrimeve është metafora më e qëlluar për të thënë se të gjithë janë ngritur kundër këtij qyteti.

Dominimi i një kohe mbi tjetrën, jotoleranca ndaj diversitetit kulturor dhe shoqëror, u bënë shkaqe për të fshirë, korrigjuar, ndërprerë (rasti i Divan-njollit) dhe tharë inde e qeliza urbane.

Sot, në realitetin e ri, shpjegon Dr Kristina Kohlert, ekziston një garë mbarë europiane për renovim pozitiv që ka për qëllim të promovojë zgjidhjet inovative për të zgjidhur problemet e bashkëjetesës së kohërave. Për këtë arsye, kjo është çështje dhe pyetje universale: “Si mund të bashkëjetojnë e reja dhe ajo pak çka na mbeti nga kultura e këtij qyteti?”

Mbase rasti më i mirë për të dhënë përgjigje është debati për ndërtesën e Unionit. Ky monument do të mund të jetë vërtetë union i të ardhmes dhe të kaluarës së Prishtinës. Dhe ndoshta, pak nga pak, kjo frymë e re e shpëtimit do të mund të zgjerohet në tërë zonën historike të Prishtinës, që ende ekziston e plotë vetëm në memorien e njerëzve të këtij qyteti.

Sali Shoshi

Udhëheqës i Misionit të CHwB për Kosovë



PRISH-TI-NA

Eliza Hoxha, architect and urban planner
arkitekte and planere urbane

1

Emin Duraku street (1950) • Rr.Emiñ Duraku (1950)

© Institute for protection of Monuments, Prishtina • Instituti për mbrojtjen e Monimenteve, Prishtinë

PRISH-TI-NA¹

Eliza Hoxha architect and urban planner

Surprisingly, if we would do a logical etymological construction of Prishtina the name itself confesses about the logic how this city is developed through time. Prishtina is destroyed and developed for so many times in the name of war, in the name of peace, in the name of progress and modernity, in the name of nation, in the name of culturalism, in the name of colonialism, in the name of UN -isation and EU-ropeanization, in the name of privatization and globalization, and what not. Prishtina is a city that doesn't have an institutionalized memory to be vaunt of. The whole period of its existence is tagged through some guides, since the 13th century when Prishtina for the first time is mention as an important settlement and further as a city of trade fairs with many hostels, covered marked area (çarshia) with many shops, as an important trade point between Thesaloniki and Sarajevo until the end of the IWW when officially is declared as a capital city of Kosova and takes the primate of an important legitimated economical-cultural node. The communist period will not produce a kind of documents to evident the city development before the time it was proclaimed a capital city, while at the same time even the foggy picture that someone could create with very few guides and pictures from the peoples that visited Prishtina at that time will be erased to create a picture – mirror of the ideology of time. For 50 years until the latest war only two official documents will be written about Prishtina-monography of Prishtina 1965 and general urban plan of 1975. Postwar period will bring in front of us a picture of the city that changes it's face very fast telling us one more time how late were are in recording the moments of the city and evidencing the collective memories.

MOSAIC OF NARRATIONS

Few documents and photos from the past, stories and memories of citizens of Prishtina and also bring in front of us life snippets of an organic city with oriental spirit, which as other cities of that time has grown spontaneously under its own rules of wholeness. A nice environmental structure surrounded by hills in there sides and with an open view to the Kosova valley ensures an amphitheatric view of Prishtina.

1. (alb. **PRISH** = eng. DESTROY ; alb. **-TI** = eng. -YOU ; alb. **-NA** = eng. -US) ~ this double-talk headline describes the exasperation of the author regarding destruction of the Heritage of Prishtina that has been made by previous regimes (PRISH-TI) and the destructions that are being made now by us (PRISH-NA).

PRISH-TI-NA

Eliza Hoxha arkitekthe dhe planere urbane

Po të bënim një konstruktim logjik dhe etimologjik të Prishtinës, çuditërisht vetë emri 'rrëfen' për logjikën se si ky qytet është zhvilluar nëpër kohë. Prishtina u shkatërrua e u ndërtua sa e sa herë: në emër të luftës, në emër të paqes, në emër të progresit dhe modernes, në emër të kombit, në emër të kulturizimit, në emër të kolonializimit, në emër të UN-izimit dhe EU-ropanizimit, në emër të privatizimit dhe globalizimit, e çka jo tjetër. Prishtina është qytet që, nuk ka kushedi se çfarë memorie të institucionalizuar. E tërë periudha e ekzistencës së saj është e shënuar përmes disa udhëpërshkrimeve që prej shekullit të XIII-të, kur për herë të parë përmendet si vendbanim i rëndësishëm, dhe tutje, si qytet i panaireve tregtare me shumë hane, çarshi të mbuluar me shumë dyqane, si: pikë tregtare e rëndësishme midis Selanikut e Sarajevës, e deri në përfundimin e Luftës së Dytë Botërore kur ajo shpallet zyrtarisht kryeqendër e Kosovës dhe merr primatin e një pike të rëndësishme ekonomike-kulturore të legjitimuar. Periudha komuniste, jo se do prodhonte kushedi çfarë dokumentesh për ta evidentuar zhvillimin e qytetit para kohës kur ai u shpall kryeqendër e Kosovës, por edhe atë fotografi të mjegulluar që mund ta krijonte dikush nga këto pak udhëpërshkrime të njerëzve që e vizituan Prishtinën atëkohë, do ta shlyejnë për të krijuar një fotografi - pasqyrë të ideologjisë së kohës. Dhe, për 50 vite, deri në luftën e fundit, për Prishtinën do shkruheshin dy dokumente zyrtare: monografia e vitit 1965 dhe plani gjeneral urbanistik i vitit 1975. Paslufta do sjell para nesh fotografinë e një qyteti që e ndërron fytyrën e vet sa çel e mbyll sytë duke na treguar edhe një herë se sa të vonshëm jemi në shënimin e momenteve të qytetit dhe evidentimin e memoareve kolektive.

MOZAIKU I RRËFIMEVE

Dokumente e foto të pakta nga e kaluara, rrëfime dhe memoare të qytetarëve të Prishtinës së vjetër sjellin para nesh copëza jete të një qyteti organik me shpirt oriental, i cili si edhe qytetet e tjera në atë kohë u zhvillua spontanisht nën rregullat e veta të tërësisë. Një strukturë e bukur mjedisore e rrethuar në të tri anët e saj me kodra dhe me një pamje të hapur kah fusha e Kosovës siguron një pamje amfiteatrale të qytetit të Prishtinës.



City Center (1955-1960) • Qendra e qytetit (1955-1960)

© Institute for protection of Monuments, Prishtina • Instituti për mbrojtjen e Monumenteve, Prishtinë

Using wisely the topographic and the environmental conveniences the old city was built spontaneously in between the two hills that way creating a pleasant panoramic scene. The dimensions of the city, the urban matrix, the network old narrow and curved patchwork streets emphasized the compatibility of the city structure. The core of the city was composed by public functions surrounded by housing areas expanded approximately similarly in four directions of the city. The groups of family houses surrounded with backyards and the outer wall were creating blocks of irregular shapes. The division of the private space to the public one was strictly done by the wall that surrounded the gardens of the houses. The narrow curved streets around the blocks were declaring the strict privacy of these family residential groups, traditionally named "mahalla" – neighborhoods. That way the women belong to the indoor world while the outside and the public belonged to the men's life. The two main urban tissues that impacted the development of that time were "divanjolli" or the tissue east – west that came from "toukbahqe" and passed through the city centre where the market area was placed continuing this way toward west to the train station – this was known as the main public tissue in the city. The north – south tissue was more important from economical point of view since through it the trade caravans were passing the city of Prishtina and going to the important cities in the Balkans. Through time this road will become the main chain of the physical development of the city.

Duke i shfrytëzuar me mençuri përparësitë (potencialet) mjedisore dhe topografike, qyteti i vjetër i Prishtinës u ndërtua spontanisht midis dy kodrave, atëkohë krijonte një skenë të bukur panoramike. Dimensionet e qytetit, matrica urbane, rrjeti i rrugëve të ngushta e të lakuara theksonin kompaktësinë e strukturës së qytetit. Bërthama e qytetit ishte e kompozuar nga përmbajtjet publike e rrethuar me zonat e banimit të shpërndara afërsisht njësoj në të katër drejtimet e qytetit. Grupi i shtëpive familjare, të rrethuara me oborre të mëdha dhe mur të jashtëm krijonte blloqet e formave të parregullta. Ndarja e hapësirës private nga ajo publike bëhej strikt me murin e lartë të jashtëm që rrethonte oborret e këtyre shtëpive. Rrugët e ngushta rreth këtyre blloqeve deklarorin intimitetin e këtyre grupeve familjare që tradicionalisht njiheshin me emrin "mahalla" – lagje. Asokohe femra i takonte hapësirës së brendshme, përdërisa jeta publike i takonte meshkujve. Dy indet - rrugët kryesore që e ndikuan zhvillimin e atëhershëm ishin: "divanjolli", apo indi lindje – perëndim që vinte nga Taukbahcja dhe kalonte mu përmes qendrës së qytetit, ku zinte vend çarshia dhe vazhdonte deri te stacioni i vjetër i trenit (në Arbëri) i njohur si indi i jetës publike në qytet. Indi tjetër veri – jug ishte më shumë i një rëndësie ekonomike për qytetin, përmes të cilit, karvanët kalonin për në qytetet e tjera të rëndësishme të Ballkanit. Përgjatë kohës kjo rrugë do të shndërrohej në një bosht të zhvillimit fizik të qytetit.

ERASING THE PAST “URBAN - IZATION”

19 November 1944 was proclaimed as a new birthday of Prishtina which after the WWII remains again under the territory of Yugoslavia. Along with that a new face of the city had to appear for the new social order. Disperse of traditional values and life styles through new forms of architecture after the WWII in Prishtina started exactly by attacking at her genius loci. Since from 1947 when Prishtina gain the executing role of political and administrative center of Kosovo and became the capital city we are witness of drastic changes in the name of progress, unity, fraternity and freedom - in the name of **modernization**. A new socialist order had to bring a new city which had to be in harmony with other urban centers of Yugoslavia. Those “the elements of urban prosperity of Prishtina are purely of political nature.” We all remember the famous refrain of the song “internacionala”, as a following up song of the voluntary actions of that time in the development process of the city. Under its sounds the old Prishtina and its nucleus was destroyed. The main urban tissue “divanjlli” was cut to leave a space for a modern city crown – the square “egalite - franternite” and the two main institutions of the political life – municipality and the parliament. Detriment of the physical carriers of tradition and culture of the city will dezer/destroy the complexity of the city center while making several known and important economical – trade families of that time to be detached from the tradition of their businesses. One was sure, everything that reminds to the past had to go with the dust of revolution because “they were not installing a new tradition but a tradition of new” Everything was based on universal norms, standards and nothing linked to the context almost with the view that this new architecture had itself an aim to dissolve the crisis which society was going through. Those expression of the city of Prishtina started to have a universal character, being similar to many others urban centers in the Yugoslavia. The urban tissue as a characteristic of urban pattern of Prishtina disperses together with the city old core. Some could say that the cities are in constant change depending on different circumstances through time so “they are never the same and never predictable”. But in Prishtina these changes were predicted with a reason behind and the aim to create a new spatial platform where the promotion and development of the new political and cultural identity will happened - Yugoslav Identity.





Destruction of the Old Market (Çarshia) • Rrënimi i Çarshisë së vjetër
© Institute for protection of Monuments, Prishtina
Instituti për mbrojtjen e Monumenteve, Prishtinë

SHLYERJA E TË KALUARËS “URBAN- IZIMI”

19 nëntori i vitit 1944 u shpall si datëlindje e re e Prishtinës, e cila pas Luftës së Dytë Botërore do mbetet përsëri nën territorin e Jugosllavisë. Bashkë me këtë një fytyrë e re për qytetin duhej të shfaqej për rendin e ri shoqëror. Andaj, shpërbërja e vlerave tradicionale dhe mënyrës së jetesës, përmes formave të reja të arkitekturës në Prishtinë do të fillonte duke e sulmuar pikërisht shpirtin e saj. Kjo pasi, zhvillimi i qyteteve socialiste, nuk do jetë më spontan si qytetet ishin zhvilluar dikur, por i bazuar në studime të ndryshme urbane të cilat bëheshin realitet përmes planeve të përgjithshme të zhvillimit ekonomik. Dhe duke e shfrytëzuar këtë kornizë në vend që të zhvillimet të orientohehin drejt hapësirave të lira në skajet e qytetit, regjimi komunist vendosi ta rimodelojë qytetin duke e atakuar nukleusin e qytetit të vjetër me vlerat eminente të arkitekturës orientale, duke mposhtur në mënyrë simbolike vlerat tradicionale dhe mbetjet nga sistemi i vjetër. Andaj, që prej 1947 kur Prishtina mori rolin udhëheqës si qendër politike dhe administrative e Kosovës, jemi dëshmitarë të ndryshimeve drastike në emër të progresit, bashkim-vëllazërimit dhe lirisë në emër të modernizimit. Kjo pasi rendi i ri socialist duhej të sillte qytetin në harmoni me qendrat të tjera urbane atëkohë në Jugosllavi, andaj “elementet e prosperitetit urban të Prishtinës janë të një natyre të pastër politike”. Të gjithëve na kujtohet refreni internacionales, aq i famshëm dhe prezent në aksionet vullnetare e aktivitetet qytetformuese të asaj periudhe. Nën tingujt e saj u shkatërrua Prishtina e vjetër e rrugëve me kalldrëm, u shkatërrua bërthama e saj (çarshia – hamami i madh), u shkëput indi kryesor urban lindje – perëndim “divanjolli” për t’ia lëshuar vendin “kurorës së qytetit modern”, sheshit “vëllazërim – bashkim” dhe dy institucioneve kryesore të politikës së atëhershme: Kuvendit të Komunës dhe Kuvendit të Kosovës. Gjallëria e çarshisë u zëvendësua me zbrazëtinë e një sheshi të monitoruar nga të dy anët, e që ironikisht, sot jep një lidhje logjike për zbrazëtinë apo formalitetin e platformës së “vëllazërim - bashkimit” të dikurshëm. Shkatërrimi i bartësve fizikë të kulturës dhe traditës në qytet do e shkretojë kompleksitetin e qendrës së qytetit, duke bërë njëkohësisht që shumë familje të njohura të udhëheqjes së ekonomisë lokale, që njëherit ishin figura të rëndësishme dhe me ndikim në shoqërinë e atëhershme, të shkëputën nga tradita e bizneseve të tyre.

“ÇARSHIA” the old market area

The main urban tissue “divan-jolli” and the market area were located exactly in the center of the city... “carshia” spread out from north-east towards west. A market area in Prishtina was characterized for its two parts: the covered and uncovered one. The main street had a direction east- west and was relatively wide in comparison with other streets. It was richer in its functional content; this was a place where trade and handicraft activities were gathered in the city. Most of the buildings besides “carshia” were built by pleasant natural materials, without any monumentality and in proportions of human scale. At the end of “carshia”, going towards the smooth downhill towards east 3 main mosques are located dominating with the space through their height and dimensions. The space around the mosques was creating a small irregular square around which, clock tower-“sahat kulla” and public baths- “ hammam” were located. As old people say Jewish's were owners of a big number of shops especially in the part of the covered market area at the end of which also a synagogue “avra” was placed. Shops were 1 or 2 stories high and their number was around 500, as mention in some of the documents of that time.

The mysticism of old narrow streets obviously was not there anymore. The huge boulevard with stereotype buildings has taken their place as a new center to accommodate the programs of enlightenment and new life style of society in the city. A boulevard became a stage, a place where you go to see and to be seen. For most of us maybe there is no nostalgia for the old city since its exactly the new boulevard as a space where our stories for the city of Prishtina begin. In missing experience and knowledge about the old city, it is normal that a detachment in identification with it exists, as a generation that learned about the city more from songs and stories of old Prishtina citizens.

But an 70-80 years old man who lost his tree where he met his first love, his market corner and his tea - coffee shop he will for sure be nostalgic because the destruction took away a part of his life's and feelings linked to that.

When Rossi says that “The city is the locus of the collective memory and that this memory is associated with objects and places”¹; in this case when the

1. Aldo Rossi – “Typological questions” and “Collective Memory” – 1982 in “The City Cultures Reader” edited by Malcom Miles, Tim Hall and Iain Boredden, Routledge 2000 – London and New York, pp – 172

Një gjë ishte e sigurt, se gjithçka që i takonte të kaluarës duhej të shkonte me pluhurin e revolucionit, pasi nuk po instaloheshin traditë e re, por një traditë e së resë. Gjithçka bazohet në norma e standarde universale dhe asgjë nuk lidhet me kontekstin se arkitektura e re kishte si qëllim të vetëm zgjidhjen e krizave nëpër të cilat po kalonte shoqëria. Në këtë mënyrë, shprehja e qytetit të Prishtinës filloi të merrte karakter universal, duke filluar të duket ngjashëm me qendrat të tjera urbane të ish-Jugosllavisë. Disa mund edhe të thonë se qytetet janë në ndryshim konstant, si shkak i rrethanave të ndryshme gjatë kohës, por në Prishtinë, këto ndryshime kishin një arsye dhe qëllim: në prapavijë të krijojnë një platformë hapësinore për promovimin dhe zhvillimin e një identiteti të ri kulturor e politik, atëkohë – Identiteti Jugosllav.

“ÇARSHIA”

Indi kryesor urban, “divan-jolli,” dhe, zona e tregut shtriheshin mu në mes të qendrës së qytetit. “Çarshia” karakterizohet prej dy pjesëve: pjesës së mbuluar dhe asaj të hapur. “Divanjolli” ishte një rrugë shumë e gjerë në krahasim me rrugët e tjera dhe e pasur me shumë përmbajtje. Kjo ishte hapësira ku karvanët tregtarë dhe aktivitetet zejtare ishin të grumbulluara. Shumica e objekteve pranë çarshisë ishin të ndërtuara nga materialet e këndshme natyrore, pa ndonjë monumentalitet të theksuar, në proporcion me shkallën humane. Në përfundimin e çarshisë, në drejtim të tatëpjetës për Taukbaççe, kah lindja, tri xhamitë kryesore ishin pozicionuar duke e dominuar hapësirën për nga dimensionet dhe lartësia e tyre. Hapësira përreth xhamive krijonte një shesh të parregullt pranë të cilin ishin vendosur, po ashtu edhe sahat-kulla dhe hammami. Nga rrëfimet e njerëzve të vjetër të qytetit, numri i madh i dyqaneve të çarshisë ishin në pronësi të jahudijve, posaçërisht pjesa e dyqaneve në zonën e çarshisë së mbuluar në përfundim të së cilës ishte e vendosur sinagoga “avra”. Dyqanet ishin 1 deri në 2 kate dhe numri i tyre arrinte diku në 500, siç thuhet në disa dokumente të asaj kohe.

Në këtë mënyrë u zhduk misticizmi i rrugëve të ngushta, u zhduk për t'ia lëshuar vendin bulevardit të ri (atëherë “Marshall Tito”, sot “Nëna Terezë”) si qendër e re e qytetit për t'ia akomoduar programet e iluminizmit dhe stilit të ri të jetës së shoqërisë në qytet. Bulevardi u bë vend-skenë, ku njerëzit shkonin për të parë dhe për t'u parë. Për shumicën prej nesh ndoshta edhe nuk ekziston

locus is erased and destroyed the collective disperse into individuals, to those who still miss and enjoy the memories of the their lost city.

Those “the value of the history seen as the collective memory, as the relationship of the collective to it's past, is that it helps to grasp the significance of the urban structure, its; individuality and its architecture which is the form of this individuality.”² Unfortunately Prishtina is not that case and I'm afraid that the history is repeating again only this time the actors are a different one, since currently also Prishtina of my childhood as I remember is disappearing every day and more.

2. Aldo Rossi – “Typological questions” and “Collective Memory” – 1982 in “The City Cultures Reader” edited by Malcom Miles, Tim Hall and Iain Borenden, Routledge 2000 – London and New York, pp – 172



© Institute for protection of Monuments, Prishtina

Nostalgjia për qytetin e dikurshëm, ngase është pikërisht ky bulevard prej ku fillon rrëfimi i gjeneratës sonë për qytetin e Prishtinës. Në mungesë të eksperiencës dhe të njohurive për qytetin e dikurshëm është normale që ekziston një shkëputje në identifikimin me të, si një gjeneratë, e cila mësoi rreth tij më shumë nga këngët dhe gojëdhënat e të moshuarve prishtinas. Por për një 70-80 vjeçar i cili humbi drurin ku e takoi dashurinë e parë, kafenenë e tij në qoshe, tregun dhe shëtitoren e tij, nostalgjia nuk mungon, ngase shkatërrimi mori me vete një pjesë të jetës së tij dhe emocioneve të lidhura për të. Le ta kujtojmë atë që shumë urbanistë e arkitektë e potencojnë “se qyteti është vend i memories (kujtesës) kolektive dhe kjo memorie (kujtesë) është e lidhur me objekte dhe vende”. Në rastin tonë, kur vendi është shlyer dhe shkatërruar, kolektivja shpërbëhet në individuale tek ata që ende e jetojnë dhe kënaqen me memoaret për qytetin e tyre tashmë të humbur. Për këtë arsye, vlera e historisë e shikuar si kujtesë kolektive, si një marrëdhënie e kolektives me të kaluarën ndihmon të kuptojmë domethënien e strukturës urbane, individualitetin dhe arkitekturën e tij që është formë e këtij individualiteti. Për fat të keq, Prishtina nuk është ky rast dhe frikohem se historia po na përsëritet, vetëm se aktorët kanë ndryshuar, ngase edhe Prishtina e fëmijërisë sime që mbaj mend unë, po zhduket çdo ditë e më shumë.



ERASING THE PAST "RURBAN-IZATION"

Today the problem stands in the fact that both cities are gone: the old one because of new (modern) and the new one again because of new (postmodern) In post war conditions joint with all other "post's as a reflection of the crisis of modernism, what the city became in this transitional phase is very hard to find the proper grammar in both layers: physical and social. Post-war brought the relieve of a frustration and spiritual compression collected for so many years which mostly is visible and reflected through the physical structure, turning this way a city into an open book of the mental conditions of kosovar society. The whole city became a workshop itself, where everyone builds for its own pleasure what ever and wherever they want - buildings, kiosks; vertical and horizontal adding's into existing structure, metal fences, different colors and materials. Again without any logic in the name of culture, in the name of privatization and globalization – in the name of status?!...

Again while killing the past Prishtina is built by all and managed by none. Prishtina belongs to all and at the same time to none. She is never the one, always escaping from itself. This way the new became old, the old or the past became a memory and the present became chaotic, noisy, irregular, multi-coloured, multilayered, multi – whatever becoming this way everyday less than a city. Planers of Prishtina decided one more time "strategically" to bring order while cleaning the city again for bringing a new better future. Again in the city center- again in the same place. IRONIC!

Peoples are left out from planners dream since according to them "they have to start listening to the planners and politicians, for what they should do and how to behave in the city". in today's inclusive world how could one think like that? People don't listen since there was no one to listen to them for such a long time. and while planners and politicians are preoccupied only with the future life goes on and things have to be done in one way or the other. This is the reason why we think that for making possible a better present and future as firstly a proper platform of communication should be settled. In the age of communication a joint language is a necessary one as a way of understanding each other, as a way of creating an alternative future for all

We lost our city twice and it's the final time to change our course, now!

SHLYERJA E TË KALUARËS "RURBAN – IZIMI"

Sot problemi qëndron në faktin se të dy qytetet kanë shkuar: i vjetri për hir të së resë (modernes) dhe i riu përsëri për hir të së "resë" (posmodernes). Në konditat e pasluftës, me të gjitha "post" konditat e përcjellura si krizë e modernizmit, se çfarë qyteti është sot në këtë fazë tranzicioni, vështirë se do të mund të gjenim gramatikën e duhur në të dy shtresimet; fizike dhe sociale. Paslufta solli çlirimin e një frustracioni dhe ndrydhjeje shpirtërore të mbledhur prej vitesh, i cili më së shumti reflektohet në strukturën fizike duke e shndërruar qytetin në një libër të hapur të gjendjes mentale të shoqërisë kosovare. I tërë qyteti është shndërruar në një punishte në vete, ku secili ndërton për qejfin e tij si dhe çfarë dëshiron: objekte e kioske, shtesa horizontale e vertikale, kunja e barriera të hekurta, ngjyra e materiale që përdoren përsëri pa ndonjë shenjë të kulturës, në emër të privatizimit e globalizmit – në emër të statusit?!...Përsëri duke e mbytur të kaluarën, tash e sa kohë, Prishtinën e ndërtojnë të gjithë e thuajse nuk e menaxhon askush. Prishtina është e të gjithëve dhe në të njëjtën kohë e askujt!?...Ajo kurrë nuk është ajokurrë nuk është e njëjtë. Gjithherë duke ikur nga vetvetja. Kështu, e reja u bë e vjetër, e vjetra një kujtim, dhe, e tashmja kaotike, e zhurmshme, e parregullt, shumëngjyrëshe, e shumë shtresuar prej shumëçkaje, duke u dukur gjithnjë më pak se qytet. Planerët e Prishtinës edhe një herë vendosën "strategjikisht" që ta kthejnë rregullin duke e pastruar qytetin përsëri për të sjellë një të ardhme më të mirë? Përsëri në qendër përsëri në vendin e njëjtë? Ironi..... Njerëzit janë të përjashtuar nga ëndrra e planerëve, pasi sipas tyre "ata duhet të fillojnë t'i dëgjojnë planerët dhe politikanët për atë se çfarë duhet të bëjnë dhe si të sillen në qytet"... Në botën e sotme gjithëpërfshirëse, si mundet ndokush të mendojë ende kësaj?! Njerëzit nuk dëgjojnë, pasi nuk kishte kush t'i dëgjonte ata për kohë kaq të gjatë. Dhe, përderisa planerët e politikanët tanë preokupohen vetëm me të ardhmen, jeta vazhdon tutje dhe gjërat duhet të bëhen në një mënyrë apo tjetër. Kjo është edhe arsyeja pse mendoj se për të bërë të mundur një të tashme dhe ardhme më të mirë për të gjithë, së pari duhet të rivendoset një komunikim i duhur.

Në epokën e komunikimit një gjuhë e përbashkët është e nevojshme për t'u kuptuar, si mënyrë e ndërtimit të një të ardhme alternative për të gjithë. Ne humbëm qytetin tonë dy herë, andaj është koha e fundit të fillojmë ta ndërrojmë drejtimin e udhëtimit, TANI.

Several notable monuments in Prishtina • Disa objekte me vlere monumentale në Prishtinë
Prof. Dr. Fejaz Drançolli, art historian

© Photo: Institute for protection of Monuments, Prishtina
Instituti për mbrojtjen e Monumeteve, Prishtinë



Several notable Monuments in Prishtina

Prof. Dr. Fejaz Drançolli, art historian


With the spreading and embrace of the Islamic religion from seventh century onwards in different parts of the globe like in Arabia, Africa, Asia and Europe, among other things, the Islamic culture and arts also began to appear and flourish. Islamic arts were not the same in all areas it appeared but it was distinguishable through certain characteristics which would be enriched with local elements. This type of art was different in Arabian countries and in Asian, Indian, European and in particular Balkans countries.

The Islamic art, a great and the very last of its kind in the East, was closely linked to the creation of Arabian-Islamic empire as well as with the spreading of the new faith Islam, which joined its believers and in a deep and comprehensive way like no other religion inspired the Oriental Islamic art. The Oriental Islamic art was particularly influenced by the Sassan, Roman and Byzantine arts. A special characteristic of this art is the decorative use of the Arabian alphabet while architecture is the main expressive mean. The painting and decorative sculpture as well as the artisan produce like rugs, ceramics and weapons served and decorated architectonic areas and their premises.

With the infiltration of Ottoman Turks in the Balkans Peninsula in fourteenth and fifteenth centuries, Kosovo also fell under their rule (1455). With the Ottoman-Turkish invasion and the installment of the feudal military regime, their administration was also established and the construction and development



The grave of Sultan Murat in Mazgit village • Varri (tyrbja) i Sulltan Muratit në fshatin Mazgit



Disa objekte me vlera monumentale në Prishtinë

Prof. Dr. Fejaz Drançolli, historian arti

Me përhapjen dhe përqafimin e fesë islame, që nga shek. VII-të dhe në periudhat pasuese në vende të ndryshme të rruzullit tokësor, si: në Arabi, Afrikë, Azi dhe Evropë filloi, pos tjerash, të paraqitet dhe lulëzoi kultura dhe arti islam. Arti islam, nuk ishte i njëjtë në çdo pjesë ku u përhap, por dallohej me karakteristika të veçanta që pasuroheshin me elemente vendore. Arti në fjalë dallohet nga vendet arabe, prej vendeve aziatike, indiane, në mënyrë të veçantë, prej atyre evropiane dhe ballkanike.

Arti islamik, art i madh dhe i fundit në Lindje, që në lidhje të ngushtë me krijimin e perandorisë arabo-islame, si dhe me përhapjen e fesë së re, Islamit, e cila me tepër se çdo religjion lidhi besimtarët e vet dhe, thellësisht, e në mënyrë të gjithanshme, i frymëzoi me artin oriental islamik. Në artin oriental islamik, posaçërisht ndikoi arti sasanit, romak e bizantin. Vetë karakteristike e këtij arti ishte përdorimi dekorativ i alfabetit arab, kurse arkitektura si mjet kryesor shprehës. Piktura dhe skulptura dekorative si dhe veprat e artizanaleve: qilimi, tekstili, keramika dhe armët shërbyen dhe dekoruan hapësirat arkitektonike, si dhe objektet e mjedisëve të tyre.

Me depërtimin e turqve osmanlinj në Gadishullin Ballkanik, në shekujt XIV-të e XV-të, edhe Kosova bie nën sundimin e tyre (1455). Me pushtimin turko-osman dhe me vendosjen e regjimit feudal ushtarak, u vendos administrata e tyre dhe nisi ndërtimi dhe zhvillimi i qyteteve me ndikim oriental, osman në



Mosque of "Çarshia" • Xhamia e "Çarshisë"

of towns under Oriental and particularly Ottoman influence began as elsewhere in areas inhabited by Albanian population.

We take look back at the fourteenth century, namely at 1389. We are in the village of Mazgit at the location where Sultan Murat Hüdavendigâr was killed by a treacherous act. The village in question is also where the grave and the temple of the Ottoman emperor are. The temple was constructed by Beyazit right after the Battle of Kosovo. Originally the grave was modest just like graves of any other believer of Islam. It got the existing appearance at the late 19 century, specifically in the first decade of 20 century. As a mausoleum it belongs to the baroque Islamic-Kosovar art. The grave or the temple of Murat is the first monument of the Islamic faith in Kosovo that faces Mecca.

Emperor Beyazit lay the foundation of the Bazaar Mosque in Prishtina on the year when Sultan Murat was killed not only in sign of remembrance for Sultan Murat but also for the needs of Ottoman believers as well as for spreading the Islamic faith and culture with the local residents. The works continued also during the rule of Murat II but the project was finalized by Mehmed II in the seventh decade of the fifteenth century.

It is especially worth noting that the location where the foundation of the monument in question was laid was originally a marketplace of an open character. The market, the mosque and subsequently the carsija are elements characteristic of the birth and development of Albanian towns during the period of Ottoman rule. It has to be stressed that the mentioned specificity was not characteristic of towns of the Ottoman-Turkish Empire.

Therefore, the mentioned characteristic as well as other local elements helped in the development of first Albanian towns under Ottoman influence during the Turkish Empire. This was typical for the old town of Prishtina of the

veçanti, si gjatë në vende të ndryshme shqiptare.

Të kthehemi në shek. XIV-të, konkretisht në vitin 1389. Jemi në fshatin Mazgit, në vendin ku në pabesi u vra Sultan Murat Hüdavendigâr. Në fshatin në fjalë është edhe varri, Tyrbja e perandorit osman. Tyrben e ngriti Bajaziti, menjëherë pas Betejës së Kosovës. Në fillim ishte një varr modest, po sikurse varret të tjera të çdo besimtarit të konfesionit islam. Trajtat e sotme i fitoi në fund të shekullit XIX-të, përkatësisht në dekadën e parë të shekullit XX-të. Si mauzole i takon stilit të barokos islamo-kosovar. Varri apo tyrbja e Muratit është objekti i parë i konfesionit islam në Kosovë i orientuar nga kibla apo Meka.

Në përkushtim të Sulltan Muratit, por edhe për nevojat e besimtarëve osmanë, si dhe të përhapjes së fesë dhe kulturës islame tek vendorët, perandori Bajaziti vuri themelet e Bazar Xhamisë, në Prishtinë, në vitin kur edhe u vra sulltan Murat. Punët vazhduan edhe gjatë kohës së Muratit II, por në tërësi u realizua nga Mehmeti II në dekadën e shtatë të shek. XV-të.

Është më interes të veçantë të theksohet, se në vendin ku u vuan themelet e objektit në fjalë ishte një treg a pazar i karakterit të hapur. Tregu, xhamia, e pastaj çarshia janë elemente karakteristike të lindjes dhe zhvillimit të qyteteve shqiptare gjatë periudhës të sundimit osman. Duhet cekur se specifikiteti i zënë në gojë, nuk ishte karakteristik për qytetet e Perandorisë turko-osmane.

Pra, me karakteristikën e cekur, si dhe me elementet të tjera vendore filluan të zhvillohet qytetet e para shqiptare në ndikim osman gjatë sundimit të perandorisë turke. Kjo ishte cilësore edhe për qytetin e vjetër të Prishtinës të periudhës osmane shek. XV-të deri në vitin 1912.

Në kuadër të Xhamisë së çarshisë a Tash xhamisë (quhet kështu, sepse duke filluar nga baza, papuqa, trupi, sherefeja, peteku e deri në pjesën konike a qylahu është e realizuar, konstruktuar me material guri) u ndërtua edhe Hamami

Ottoman period, fifteenth century - 1912.

Carsija Hamam was built within the mosque or the Tas mosque (this name derives from the fact that the basis, the body, sherefe, honeycomb and up to the conic part or the qulah is built of stone material). The Hamam as a public monumental building was a symmetrical “couple” hamam. We use the past tense to refer to it because it no longer exists. This Hamam is not even mentioned by the travel writer Evlia Çelebi in his writings during the visit to Prishtina.

However, during the construction of Kosovo Executive Council now Kosovo Assembly and the street between the building in question and Carsija Mosque, the workers discovered the ruins of a hamam. We do not possess any information or documenting material for research on the ruins of the hamam. They were destroyed. Even today it is possible to see some shapes of the foundation of this building. These shapes of the constructive walls are located near the Kosovo Assembly building, in the back under the stairs.

This location is also where the Old Carsija of Prishtina in a covered-bezistan type was. This carsija was ruined in the sixth decade during the construction of the above mentioned building. This was the time when the motto “Out with the old, in with the new!” was very much present. This was the motto that guided the work of the politicians and urban planners ...According to Çelebi, there were 300 shops in Prishtina. The mentioned motto dominated over many other buildings be it laic or religious. Many mosques and Kosovar Christian Catholic churches were ruined. As mentioned, the donor Mehmed Fatih II also built the King’s Mosque or the Great Mosque in 1460/61. The same also constructed the Great Hamam in



Old Hamam ruins • Mbetjet nga Hamami (i Çarshisë) i Vjetër

i Çarshisë. Hamami si objekt monumental publik ishte “çift” hamam simetrik. Them i ishte, sepse tani nuk ekziston. Hamamin në fjalë, nuk e përmend as udhëpërshkruesi Evlia Çelebiu në përshkrimet e tij kur vizitoi Prishtinën.

Mirëpo, gjatë ndërtimit të ndërtesës së ish Këshillit Ekzekutiv të Kosovës, tani të Parlamentit të Kosovës, si dhe të rrugës në mes të ndërtesës së përmendur dhe të Çarshi Xhamisë, është hasur në themelet e hamamit. Nuk kemi dijeni e as material dokumentues për hulumtimin e rrënojave të hamamit. Ato u shkatërruan. Edhe sot mund të shihen disa trajta të themeleve të objektit në fjalë. Këto trajta të mureve konstruktive janë në afërsi të ndërtesës së Parlamentit të Kosovës, në anën e prapme, nën shkallare.

Në këtë lokacion të cekur ishte edhe Çarshia e Vjetër e Prishtinës e tipit të mbuluar-bezistan. Kjo çarshi u rrënuar në dekadën e gjashtë, pra gjatë fazës së ndërtimit të ndërtesës. Ishte periudha kur i trumbetohet motos: “Rrënojmë të vjetrën për të ndërtuar të renë!” Me këtë moto vepronin politikanë dhe urbanistë. Sipas Çelebiut, në Prishtinë kishte 300 dyqane. Moton e cekur e përjetuan edhe shumë objekte të tjera si laike, po ashtu edhe fetare. U rrënuar edhe shumë xhami e kisha krishtere e katolike kosovare.

Siç u theksua, donatori Mehmet Fatih II ndërtoi edhe Xhaminë e Mbretit a Xhaminë e Madhe në vitin 1460/61. Nga i njëjti u realizua edhe Hamami i Madh në Prishtinë. Sa i përket datës së ndërtimit të xhamisë kemi mendime të ndryshme (Ipen, Radoniq, Jireçek, Kovaçević, Kojiq), por data e vërtetë është mbishkrimi i gravuar mbi portalin hyrës të Xhamisë, ku është shënuar emri i donatorit si dhe data 865 sipas hixhrit.

Shënime për Xhaminë e Madhe kemi edhe te autorët F. Drançolli



The Great Hamam • Hamami i Madh



Mosque of "Llap" • Xhamia e Llapit

Prishtina. With regards to the date of the mosque's construction, there are different thoughts (Ipen, Radoniq, Jirecek, Kovacevic, Kojic), but the real date is inscribed above the entrance portal of the Mosque which has the name of the donor and the date 865 according to Hijr.

Notes on the Great Mosque can also be found by the authors F. Drançolli and S. Rizaj. According to the author Rizaj, even the neighbourhood later took the name of the mosque's donor "Mahala of Sultan Mehmed's Mosque, han gazi" (Glorious sovereign, Mehmed II, The Conqueror).

Great Hamam was constructed in the vicinity of the Mosque and the former has a full compositional scheme and is "couple" of public hamams. Building of hamams near mosques was characteristic of Ottomans which was also carried over to Albanians.

Fifteenth century, namely the eighth decade saw the construction of the Llap a Ramadanije Mosque which was burned down during the Albanian-Serb war by Serb police forces in the spring of 1999. This mosque is very interesting and characteristic and stands out from other religious sites.

